



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 769/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Gëzim Dervishaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.769/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Gëzim Dervishaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për kandidatët për Kuvend Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në Vendvotimin: 1723C/07R

III. Refuzohet i pabazuar apeli Anr.770/2021 të datës 04.11.2021 lidhur me rinumërimin e vendvotimit, 1723C/04R për arsye se ky vendvotim veç se është rinumëruar nga KQZ-ja.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelet Anr.769/2021 dhe Anr.770/2021, nga Gëzim Dervishaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Pejë, në të cilën pretendon se në qendrën e votimit me numër 1723c/04R kandidatet kanë me shume vota se sa subjekti politik 121 AAK, ku kandidatet marrin 81 vota, ndërsa partia 55

vota, ku sipas parashtruesit te apelit është bere shkelje e rende e ligjit dhe dispozitave ligjore, ndërsa ne apelin Anr. 770/2021 kërkon qe rinumërohen votat ne vendvotimet 1723C/07R pasi qe dyshon se janë bere manovrime me vota ku votat e kandidateve prej numrit 7 e deri ne numrin 38 nuk janë evidentuar ne formularin e KQZ-se ne këtë vendvotim.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.769/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hire të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

apeli është pjesërisht i bazuar.

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që pas shqyrtimit te provave dhe shkresave te lendes për apelin Anr.769/2021, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve te shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatin nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë në këtë vendvotim 1723C/07R dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa ne pjesën e III te dispozitivit ka refuzuar apelin Anr.770/2021 për arsye se vendvotimi 1723c/04R veç se është rinumëruar nga KQZ-ja, dhe nga ky rinumërim janë evituar shume parregullsitë eventuale, andaj Paneli konstaton se nuk ka arsye qe i njëjti vendvotim te rinumërohet përsëri.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.769/21 më datë 05.11.2021



Kryesuese e Panelit
Ajlete Sada - Glllogjani

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 769/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Gëzim Dervishaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.769/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Gëzim Dervishaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për kandidatët për Kuvend Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në Vendvotimin: 1723C/07R

III. Refuzohet i pabazuar apeli Anr.770/2021 të datës 04.11.2021 lidhur me rinumërimin e vendvotimit, 1723C/04R për arsye se ky vendvotim veç se është rinumëruar nga KQZ-ja.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelet Anr.769/2021 dhe Anr.770/2021, nga Gëzim Dervishaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Pejë, në të cilën pretendon se në qendrën e votimit me numër 1723c/04R kandidatet kane me shume vota se sa subjekti politik 121 AAK, ku kandidatet marrin 81 vota, ndërsa partia 55

vota, ku sipas parashtruesit te apelit është bere shkelje e rende e ligjit dhe dispozitave ligjore, ndërsa ne apelin Anr. 770/2021 kërkon qe rinumërohen votat ne vendvotimet 1723C/07R pasi qe dyshon se janë bere manovrime me vota ku votat e kandidateve prej numrit 7 e deri ne numrin 38 nuk janë evidentuar ne formularin e KQZ-se ne këtë vendvotim.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.769/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hire të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

apeli është pjesërisht i bazuar.

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që pas shqyrtimit te provave dhe shkresave te lendes për apelin Anr.769/2021, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve te shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatin nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Pejë në këtë vendvotim 1723C/07R dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.


Ndërsa ne pjesën e III te dispozitivit ka refuzuar apelin Anr.770/2021 për arsye se vendvotimi 1723c/04R veç se është rinumëruar nga KQZ-ja, dhe nga ky rinumërim janë evituar shume parregullsitë eventuale, andaj Paneli konstaton se nuk ka arsye qe i njëjti vendvotim te rinumërohet përsëri.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Anr.769/21 më datë 05.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.